



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:160648

Datë: 31.08.2022

Numri i dokumentit: 03377130

C.nr. 1087/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllogjani me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Sadiku, në çështjen juridike të paditësit N. G. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, përfaqësuar nga Dardan Morina avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale Arsimit, kontest pune - kompensim nga marrëdhënia e punës, vlera kontestit 1,523.61 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 04 gusht 2022, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurës, me datë 31 gusht 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit N. G. nga fshati . . .Komuna e Gjakovës, në emër të diferencës së shtesës së kualifikimit në paga mujore, që nga data 18 prill 2017 deri me 03 janar 2020 për gjithsejtë 33 muaj të ia kompensoi shumën e përgjithshme prej 1,523.61 euro (njëmijë e pesëqind e njëzet e tre euro e gjashtëdhjetë e një cent) pra 19% të pagës bazë në lartësi prej 46.17 euro për 33 muaj duke llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në nivel vjetor e cila rrjedh nga data 04 gusht 2022 e deri në pagesën definitive, si dhe të ia kompensoi shpenzimet procedurale në shumë të tërësishme prej 326.80 (treqind e njëzet e gjashtë euro e tetëdhjetë cent), e që krejt këto të ia paguaj në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi me padi , parashtresë nëpërmjet të autorizuarit të tij ka parashtruar se është në marrëdhënie pune të e paditura në shkollën “Haxhi Hoti” në fshatin Rogovë, Komuna e Gjakovës, i njëjti ka 33 muaj të punës për të cilën periudhe kërkohet kompensimi nga marrëdhënia e punës, paditësi ka të kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Paditësi është i licencuar si mësimdhënës nga MASHT-i, nga data 26 dhjetor 2012 e deri me datë 26 dhjetor 2017. Duke iu referuar faktit se paditësi është i licencuar i takon e drejta në 19% të pagës bazë në kuptim të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës në nenin 7 paragrafi 1 pika 1.2 dhe në kuptim të Vendimit të nxjerr nga Qeveria e Kosovës me nr.01/33 të datës 29 gusht 2008. Paditësi referuar listës së pagave për nivelin e shkollimit dhe referuar licencimit është kompensuar nga e paditura në shumën prej 30.78 euro nga shuma që është dashur të i paguhej prej 76.95 euro, andaj bazuar në të gjitha konstatimet e lartcekura paditësi e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, duke theksuar se paditësit për periudhën kohore 18 prill 2017 e deri më 03 janar 2020, në emër të kompensimit të diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit, të ia paguaj shumën prej 1,523.61 përkatësisht paga bazë 405 euro x 19% e pagës bazë = 76.95 euro – 30.78 euro diferencë e paguar në pagë = 46.17 euro x 33 muaj gjithsej 33 x

46.17 = 1,523.61 euro, me kamate ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave është vërtetuar në tërësi baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, po ashtu është vërtetuar fakti se e paditura nuk e ka paguar në tërësi diferencën në pagë duke iu referuar bazës së kualifikimit dhe licencimit. Është vërtetuar po ashtu fakti se paditësi për periudhën kohore sipas kërkesëpadisë ka qenë i licencuar dhe përkundër faktit se licenca e dorëzuar dhe e administruar si provë ka datën e skadimit 26 dhjetor 2017, lidhur me vazhdimin e licencimit për paditësin në fjalë edhe për 5 vitet e ardhshme nga viti 2017 është rregulluar me UA numër 05/2017. Andaj i propozon Gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e precizuar.

Shpenzimet procedurale i kërkoi sipas TA , për taksë gjyqësore, përpilim të padisë dhe përfaqësim në seanca.

Sipas Aktvendimit C.nr.1087/21 të datës 22 korrik 2021, Gjykata ia ka dërguar padinë paditëses dhe e ka ftuar që të paraqes përgjigje në padi, mirëpo e njëjta Aktvendimin në fjalë e ka pranuar me datë 23 korrik 2021 dhe siç rezulton nga shkresat e lëndës e paditura deri me tani nuk i ka paraqitur Gjykatës përgjigje në padi, andaj Gjykata ka vepruar konform nenit 400 paragrafi 2 të LPK-së.

Shqyrtimin përgatitor - kryesor i caktuar më datë 04 gusht 2022, Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt që vërtetohet sipas fletëkthesës së Gjykatës e cila nga e paditura është pranuar me datë 25 korrik 2022 dhe me propozimin e të autorizuarit të paditëses, sipas nenit 409.2 dhe 423.4 të LPK-së, është mbajtur seanca gjyqësore në mungesë të paditurës.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave: Kontrata e Punës me numër të protokollit 25/15 e datës 01 shtator 2015 (fotokopje), Diploma e Universitetit të Kosovës në Prishtinë – Shkolla e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda”- Prizren drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, LRP. nr.6765/2021 e datës 08 korrik 2021, Licenca e mësimdhënësit me numër 100009154 e datës 26 dhjetor 2017, dhe lista e pagave për muajin janar 2018, janar dhe dhjetor 2019, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është e bazuar dhe u aprovua.

Nga kontrata e punës e datës 01 shtator 2015 vërtetohet se paditësi në cilësinë e mësimdhënësit të lëndës së Gjuhës Shqipe në shkollën “Haxhi Hoti” fshati Rogovë, Komuna e Gjakovës me kualifikimin Sh.L.P në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe – Shkolla e Lartë Pedagogjike ka lidhur kontratë të përhershme të punës. Paditësi posedon Diplomë të kualifikimit të lartë shkollor Shkolla e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” në Prizren me numër të protokollit 01-56 e datës 27 shkurt 1987 dhe ka marrë titullin arsimtar i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Universitetit të Kosovës në Prishtinë. Paditësi posedon licencën e karrierës së mësimdhënësit me numër 100009154 e lëshuar me datë 26 dhjetor 2012 deri me datë 26 dhjetor 2017, me të cilën vërtetohet se paditësi është licencuar për periudhë pesë vjeçare. Nga lista e pagave e muajit janar 2018, vërtetohet se paditësi N. G. është në cilësi të mësimdhënësit në shkollën fillore me kualifikimin Shkolla e Lartë Pedagogjike, realizon pagën bruto në shumë prej 378.27 euro, për kualifikim me Sh.L.P realizon shtesën 30.78 euro, , pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 342.09 euro. Nga lista e pagave për muajin janar 2019 paditësi ka realizuar pagën bruto në shumë prej 377.06 euro, ku hynë edhe shtesa për kualifikim SHLP në shumë prej 30.78 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421” ka realizuar pagën neto në shumë prej 341.04 euro, në

muajin dhjetor 2019, vërtetohet se paditësi N. G. është në cilësi të mësimdhënësit në shkollën fillore me kualifikimin Shkolla e Lartë Pedagogjike, realizon pagën bruto në shumë prej 379.85 euro, për kualifikim me Sh.L.P realizon shtesën 30.78 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto në shumë 343.46 euro.

Lidhur me kompensimin gjegjësisht diferencën e kompensimit në paga mujore që ka realizuar paditësi, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 7 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18 prill 2017 sipas të cilës dispozitë përcaktohet se: ”Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë pika 1.2 mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% të pagës bazë andaj bazuar dhe në provat e lartcekura përkatësisht në diplomën numër 01-56 e datës 27 shkurt 1987 me të cilin paditësi ka fituar titullin arsimtar i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në shkollën SHFMU “Haxhi Hoti” në fshatin . . .Komuna e Gjakovës prej datës 27 shkurt 1987, Aktvendimi mbi licencën më numër 100009154 me të cilën vërtetohet rrethana se paditësi posedon licencën e karrierës së mësimdhënësit të vlefshme nga data 26 dhjetor 2012 deri me 26 dhjetor 2017, ashtu që sipas UA nr.5/2017 sistemit i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve ne karrierë sipas nenit 33 paragrafi 1.1 “vazhdohen për 5 vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012,213 dhe 2014. Licenca e lëshuar në këto vitet mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të VPM (vlerësimit profesional të mësimdhënësve.) . Hyrja në fuqi e Kontratës së Arsimit nga datë 18 prill 2017 deri me datën 03 janar 2020 ka qenë në fuqi dhe të njëjtit i takon e drejta për një kompensim të tillë.

Bazuar në listat e pagave të administruara gjatë shqyrtimit vërtetohet se paditësi ka realizuar pagën bazë me gradën 405.00 euro për periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e që duke llogaritur me 19% del të jetë shuma prej 76.95 euro nga duhet zbritur shtesën 30.78 euro që ka realizuar ne emër të kualifikimit SHLP, e që ka mbetur pa u realizuar shuma prej 46.17 euro për 33 muaj, pra $46.17 \times 33 = 1,523.61$ euro.

Neni 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parasheh se i punësuar ka të drejtën në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit çka rezulton se e paditura nuk i është përmbajtur Kontratës së punës dhe akteve administrative të cilat janë të zbatueshme që rezulton me pagesën e detyrimit paditësit.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensim nga marrëdhënia e punës nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësit të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (LMD) është paraparë se “ Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Dispozita e nenit 245 paragrafi 1 i LMD-së ka paraparë se :”Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtje e tij”, prej nga rezulton se debitori këtu e paditura është e detyruar që kreditorit, këtu paditësit të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë së aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me kamatën Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të LMD-së , ku parashihet se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton , përpos borxhit kryesor dhe kamatën. Paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditësit i takon edhe kamata e gjykuar sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë bazuar në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumë 20.00 euro, për përpilim të padisë shumë 104.00 euro, për një seance gjyqësore të shtyrë shumë prej 67.60 euro (apo 50% të tarifës prej 135.20) dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditësit në një seancë në shumë 135.20 euro, në shumë të tërësishme 326.60 euro.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

C.nr. 1087/21, datë 31 gusht 2022

G j y q t a r j a
Afijete Sada Gillogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.